



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:284324  
Datë: 20.05.2024  
Numri i dokumentit: 05705980

**C-IV-13-1183**

*Parashtruesi i Ankesës*  
**Kompania Ndërtimore „D“**, Gjakovë, të cilën e përfaqëson avokat, **T B**, nga Gjakova

*Kundër*

*Pala kundërshtare*  
**Agjencia Kosovare e Privatizimit- (AKP) (NH “Magjistrala”** në likuidim), Rr. “Dritan Hoxha” nr.55, Lakrishte, Prishtinë

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), sipas gjyqtarit Gazmend Sylaj, me 20 maj 2024, lëshon këtë:

**AKTGJYKIM**

- I. REFUZOHET ankesa si e pabazuar.**
- II. VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRN032-0188 i datës 5 qershor 2013.**
- III. Nuk caktohen shpenzime gjyqësore.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 8 korrik 2013, pranë DHPGJS, është parashtruar një ankesë, të emërtuar si padi, me të cilën ka kundërshtuar Vendimin e Autoritetit të Likuidimit (AL) PRN032-0188 datë 5 qershor 2013 (tani e tutje: Vendimi), me të cilin i ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa për kompensim për faturat e pa-paguara, në vlerë prej 70,857.00 ( shtatë zero tetë pesë shtatë zero zero) Euro, nga NH “Magjistrala” (në likuidim).

Ankuesi pohon se NSH “D” ka kryer punë ndërtimore për NSH “Magjistrala” në Prishtinë, duke filluar nga viti 1989.

Më tutje deklaroi se për shkak të mos pagesës së borgjit, i është drejtuar Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, me propozim për ekzekutim në bazë të dokumentit të besueshëm, dhe se lënda evidentohet sipas numrin E.nr. 631/94.

Ankuesi deklaroi se nuk posedon dëshmi materijale, me arsyetim se gjatë periudhës së luftës forcat policore ishin vendosur në objektin e ankuesit, e po ashtu ky objekt ishte bombarduar, dhe se pas përfundimit të luftës i gjithë dokumentacioni ishte hedhur në mbeturina dhe se pas sistematizimit një pjesë e konsiderueshme e dokumentacionit nuk ishte gjetur.

Ankuesi gjithashtu pohon se Gjykata Ekonomike e Qarkut të Prishtinës është bartur në Krlevë, qytet në Serbi, ku është formuar si gjykatë paralele dhe vepron si Gjykatë Ekonomike e Qarkut të Prishtinës.

Përfundimisht ankuesi kërkon që AKP të obligohet që të ja paguar borxhin, në bazë të pasurimit të pabazuar, e në shumën kërkuar.

Ankesës i ka bashkangjitur:

- Kopja e autorizimit për përfaqësuesin,
- Kopjen e Vendimit të AL,
- Kopjen e kërkesës së AKP drejtuar ankuesit për dokumentacion shtesë,
- Kopja e përgjigjes së ankuesit drejtuar AKP,
- Kopja e njoftimit të Agjencisë, datë 11 prill 2007, me të cilën shihet se NSH “D” me njësi të saj është liruar nga administrimi i Agjencisë,
- Kopja shkresës së Gjykatës Tregtare Prishtinë me seli në Kralevë (paralele në Serbi), e datës 25 prill 2006, me anë të cilës deklarohen se nuk disponojnë shkresat e lëndës P.br. 3381/92, I.br. 20684/92 dhe I.br. 631/94 – lëndë kjo e fundit në të cilën referohet ankuesi ( në tekstin në vijim SHKRESA E GJTP – KRALEVË).

AKP me 3 nëntor 2017, parashtroj përgjigjen.

AKP e kundërshtoj ankesën duke e konsideruar si të pabazuar. AKP konsideron se AL ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore i ka zbatuar në mënyrë të drejtë. Tutje, AKP thekson se kërkesa për rishikim-padia nuk përmban argumentet e saj ligjore ashtu siç edhe parashihet sipas dispozitave ligjore të Shtojcës së Ligjit për AKP. Përfundimisht AKP deklaron se edhe përkundër kërkesës së AL për dokumentacion shtesë, si ato të shkresave të Gjykatës Ekonomike të Qarkut, ankuesi nuk ka përmbushur kërkesën andaj edhe konsideron se kërkesës kreditore i mungojnë provat. Nga gjitha arsyet, AKP, propozon që kërkesa për rishikim-padia të hedhet si e papranueshme ose refuzohet si e pabazuar dhe të vërtetohet Vendimi i AL.

Përgjigjes i është bashkangjitur:

- Kopjen e kërkesës së AKP drejtuar ankuesit për dokumentacion shtesë.

Përgjigja e AKP, ju dorëzua përfaqësuesit të ankuesit me 11 nëntor 2017.

Nuk u parashtrua përgjigje.

Duke ju përgjigjur urdhrit të gjykatës datë 13 korrik 2020, përfaqësuesi i ankuesi me parashtresën e tij datë 4 gusht 2020, pohon se me kërkesën për rishikim-padi atakohet Vendimi i AL PRN032-0188 datë 5 qershor 2013. Me po të njëjtën parashtresë ankuesi mbeti në tërësi si pranë pohimeve si në kërkesën për rishikim-padi.

### **Arsyetimi Ligjor**

Kërkesa për rishikim kërkesa konsiderohet e pabazuar.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit Nr.06/L-086 të DHPGJS në lidhje me nenin 399 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, Gjykata përcakton se faktet relevante të rastit janë të pakontestueshme dhe nxjerrë këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS, thuhet si në vijim:

*“secila palë, në parashtresat e saj me shkrim, duhet të paraqesë një pasqyrë të hollësishme të fakteve dhe arsyetimit ligjor mbi të cilin vendos qëndrimin dhe argumentimin e saj; në rastin kur pala pohon të ekzistojë një fakt, ajo palë është e obliguar të paraqesë prova, fizike dhe/ose dëshmuese, për mbështetjen e atij pohimi; dhe*

*Një kërkesë apo ankesë përmban, lëndën dhe të gjitha faktet materiale që kanë të bëjnë me kërkesën ose ankesën, bazën për juridiksionin parësor të Dhomës së Posaçme në lidhje me kërkesën apo ankesën, argumentet ligjore mbi të cilat mbështetet kërkesa apo ankesa dhe një listë provash që paditësi synon ti paraqes”.*

Ankuesi si në procedurën pranë AL ashtu edhe pranë gjykatës nuk ka ofruar asnjë dëshmi, fakt, apo ndonjë arsyetim ligjor që do të argumentonte dhe të dëshmonte bazueshmërinë e ankesës, ashtu siç edhe parashihet sipas dispozitave ligjore, të cekura si më lartë.

Ankuesi për më tepër pohon se shkresat e lëndës, E.nr. 631/94, nga Gjykata Ekonomike e Qarkut të Prishtinës janë bartur në Kralevë, qytet në Serbi, ku është formuar si gjykatë paralele dhe vepron si Gjykatë Ekonomike e Qarkut e Prishtinës, gjersa SHKRESA E GJTP – KRALEVË thekson se nuk disponojnë me shkresa të tilla.

Andaj në mungesë provash, sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS gjykata konsideron se ankuesi nuk ka plotësuar kushtet ligjore të parapara sipas nenit 40 të Shtojcës së Ligjit për AKP ( ligji nr. 04/L-034) mbi përmbushjen e kërkesës kreditore ndaj tij.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

#### **Taksa Gjyqësore:**

Taksat gjyqësore janë paguar.

Në bazë të nenit 62.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

Andaj u vendos si në dispozitiv.

#### **Këshillë Juridike:**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

---

Gazmend Sylaj, Gjyqtar